



**TAKIM BILATERAL NDËRMJET ASHMA-së dhe ARKOM**

Shkup, 31mars 2022 – Përfaqësues të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizive mbajtën një takim pune me Benoa Luter, Këshilltarë i trupit rregullator të komunikimit audioviziv dhe dixhital të Republikës Franceze (ARKOM). Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i përvojave dhe mendimeve në shumë segmente mes tjerash dhe zbatimi i Direktivës së rishikuar për shërbimet mediatike audiovizive, monitorimin e përmbajtjeve mediatike gjatë proceseve zgjedhore, ndalimi i ritransmetimit ku

paraqitet si themelues Federata Ruse ose individ privat, fizik dhe juridik me origjin nga Federata Ruse. Në takim u diskutua dhe për rregullimin e rrjeteve sociale.

Në përfundim të takimit u konstatua se mardhëniet dypalëshe janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe një praktikë e tillë duhet të vazhdojë në të ardhme.

**Gjinia në programin TV sportiv në fokusin e takimit të parë publik të ASHMA-së**



Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizive më 28 mars mbajti takimin parë publik për këtë vit, në të cilën drejtori i Agjencisë dr. Zoran Trajčevski bëri një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara në pajtim me Planin vjetor të punës për tre muajt e fundit. Të pranishmit patën mundësinë të dëgjojnë për aktivitetet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e kryer të transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, botuesit e medias së shkruar, msat e shqiptuara vërejtje publike, hulumtime të bëra, aktivitete në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në takim u prezantuan dhe gjetjet nga Analiza „Gjinia në mediat 2021: Çështjet gjinore dhe mënyra e përfaqësimit të gruave dhe burrave në programet sportive në televizionet tokësore kombëtare“, e cila për herë të parë jep një pasqyrë sasiore dhe cilësore në të se sa dhe si raportojnë televizionet kombëtare për sportistet dhe sportet në konkurrencën për femrave, kundrejt sportistëve dhe sporteve në konkurrencën për meshkuj.

Analizën e përgatitur për nevojat e Agjencisë nga Instituti „Resis“ tregoi se informimi për sportet dhe ngjarjet sportive dhe transmetimi i ndeshjeve sportive, zënë një vend të rëndësishëm në total të skemës programore të Shërbimit publik të transmetuesit. Shërbimi publik përqipet të udhëheqë një politikë editoriale kohezive të menduar mirë në lidhje me sportin, dmth ka një diversitet zhanri dhe padyshim një larmi të madhe të sporteve të përfaqësuara ku ju është dhënë një kohëzgjatje e dukshme. Në programin e tre kanaleve të analizuar – MRT 1, MRT 2 dhe MRT 3, domonojnë sportet në ekipë në konkurrencën për meshkuj. Është vërtetuar prania dominuese e meshkujve mes gazetarëve kundrejt pjesëmarrjes marginale të gazetarëve, si dhe dominimi i punëtorëve sportiv meshkuj pra ekspertëve meshkuj.

Sportit në Televizionet private TV Alfa, TV Sitel, TV Kanal 5, TV Telma dhe TV Alsat-M dukshëm i kushtojnë më pak kohë sportit në lidhje me Shërbimet programore. Kjo është një gjetje plotësisht e pritshme, duke pasur parasysh se për shkak të të drejtave të blera për transmetim, televizionet private nuk kanë transmetim të Lojrave olimpikë verore. Megjithatë, ka dallime të dukshme mes pesë televizioneve private në aspekt të mbulimit të ngjarjeve sportive dhe në vëmendjen që i kushtojnë sportit. Në programin e rregullt informativ sportiv duke marrë parasysh sportet individuale dhe ekipore ka dominim të konkurrencën e meshkujve. Ekspertët e sportit mungojnë pothuajse plotësisht në programin e rregullt, ndërsa nga pikëpamjet dhe analizat për ngjarjet sportive redaksitë dominoheshin nga punëtorë meshkuj të sportit.



## NEWSLETTER

### Mbikëqyrja e transmetueseve, mediave të shkruara dhe operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

#### Transmetuesit

Mbikëqyrje e rregullt programore për më shumë obligime ligjore – respektimin e rregullave gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuale, mbrojtjen e audiencës së mitur, përdorimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, transmeti të lojrave të fatit dhe ofrimi i kuizeve dhe formave të tjera të shpërblimit, mbrojtjen e audiencës së mitur, raklemimin, sponsorimin, përdorimin e gjuhës në programe, obligime për transmetim 12 –të orë program dhe për plotësimin e kuotës për program të prodhuar burimor, shpallja impresium, informacione që duhet të vihen në dispozicion të përdoruesit dhe për shpalljen e identifikimit të transmetuesit, mbikëqyrje e rregullt administrative ndaj E Jona (Hawa) TV dhe TV 24 Lajme. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se programi në TV 24 Lajme më 4 mars të vitit 2022, është transmetuar emision dokumentar argëtues „1001 vakt обоко“ e cila nuk është shënuar si program në të cilën vendosen produkte, dhe disa produkte prezantohen përmes theksimit të tepruar pra mbitheksimit vizual dhe verbal.

Pas njoftimit të marrë nga Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë, për transmetim të paligjshëm të komunikimeve komerciale audiovizuale për suplementet ushqimore, janë kryer disa mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore ndaj TV Kanal 5 dhe TV Sitel. Nga mbikëqyrjet u konstatua se në kundërshtim me LSHMAAV më 21, 22 dhe 23 shkurt të vitit 2022 në programet e TV Kanal 5 dhe TV Siti janë transmetuar tele-shopping spote për artikujt „Bronfo protekt – 500 ml.“ dhe „Diabetol forte-30 kapsula“, operatorit ushqimor „Natura terapi“ SHPKPV Shkup, në të cilën natyra e tyre përfaqësohet në mënyrë të rreme dhe karakterizimet, dmth janë të pavërteta dhe të pandershme, me të cilën e joshin publikun dhe janë kundër interesave të konsumatorëve. Në të njëjtat data, në TV Kanal 5 janë transmetuar tele-shopping spote me suplemente shtesë në ushqim „Bronxo protekt“ në të cilin si vizualisht ashtu dhe në zë shfaqet dhe prezantuesja e rregullt e lajmeve në të njëjtin televizion, ndërsa në TV Sitel në pjesë të programit të mëngjesit, emisioni informativ-argëtues „E dua Maqedoninë“ u transmetuan komunikime të fshehta komerciale audiovizuale të produkteve „Bronxo protekt“ dhe „Prostatoll kompleks“ dhe janë transmetuar tele-shopping spote për suplemente shtesë në ushqim „Bronxo protekt“ në të cilën si vizualisht dhe në ekran shfaqet dhe prezantuesja e rregullt e lajmeve, në Kanal 5 Televizion. Gjithashtu në TV Kanal 5 është konstatuar se në kundërshtim me LSHMAAV, më 22 dhe 23 shkurt në pjesë të emisionit të mëngjesit, emisionit informativ-argëtues „Përshëndetje Maqedoni“, u transmetuan komunikime të fshehta komerciale audiovizuale të produkteve „Bronxo protekt“ dhe „Diabetoll Forte“.

Në bazë të nismave të paraqitura me shkrim nga organizara e shoqërisë civile për parimet – ndalim i posaçëm për nxitjen dhe përhapjen e diskriminimit, intolerancën ose urrejtjes bazuar në ndalimin e themelit të diskriminimit, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore ndaj TV Kanal 5 dhe TV Alfa. Mbikëqyrjet konstatuan se në programin e TV Kanal 5, në emisionin „Vetëm e vërteta“ e transmetuar më 21 shkurt dhe në programin në TV Alfa në emisionin „Çfarë është e paqartë“ e transmetuar më 23 shkurt, nuk janë shkelur ndalesat e veçanta nga neni 48 nga LSHMAAV. Për gjetjet u informuan gjithashtu dhe mediat dhe parashtruesi i nismës.

Agjencia bazuar në Kërkesën për shpjegim, informim dhe dëshmitë e pretendimeve në ankesë, dorëzuar nga ana e personit fizik tek Avokati i popullit – zyra rajonale Kërçovë, ka kryer mbikëqyrje urgjente programore për parimet e kryerjes së veprimtarisë nda emisionit „KOD“ e transmetuar nga TV Telma. Mbikëqyrja tregoi se TV Telma, në emisionin „KOD“ me titull „Një vit burg për policin e shkelur, vrasje ose vetëmbrojtja e Palës“ e transmetuar më 6 shkurt, pjesa e parë i referohet mokonfliktit gjyqësor në të cilin marrin pjesë parashtruesi i ankesës, solli një vendim editoril për publikim të emrit dhe mbiemrit të plotë të të pandehurit, datëlindja dhe vendbanimin, edhe pse procesi gjyqësor në këtë rast është në fazë të ankesës para Gjykatës së Apelit Gostivar dhe akoma nuk është marrë një vendim i formës së prerë. Me publikim e identitetit të parashtruesit të ankesës (emrin dhe mbiemrin, datëlindjes dhe vendbanimit), TV Telma veprroi në kundërshtim me parimin për „respektimin e prezumimit të pafajsisë“ nga neni 61 paragrafi 1 alinea 5 nga LSHMAAV.

#### Media e shkruar

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj 20 botues së medias së shkruar me qëllim të konstimit nëse të dhënat për strukturën e pronësisë i kanë publikur të paktën në një gazetë ditore, gjatë një viti, më së voni deri më 31 mars të vitit 2022 dhe nëse 15 ditë nga dita e publikimit kanë dorëzuar një insert nga publiku deri tek organi rregullatohet kompetent. Mbikëqyrja ka treguar se të gjithë botuesit e medias së shkruar kanë vepruar në përputhje me Ligjin për media.



## NEWSLETTER

### Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Për detyrimet që lidhen me regjistrim e shërbimeve programore në Agjencion dhe titllimin e programeve që i ritransmetojnë operatorët, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore ndaj operatorëve Robi, KDS, Kabel Net, Skreml, Transhpед Trejd, Altra Sat 2000, Inel Internacional, Kabel dhe Kabel L Net. Gjatë mbikëqyrjes nuk u konstatuan shkelje.

Për detyrimet që operatorët e ORRPKE janë të detyruar në paketën programore që eritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë të përmbajnë Shërbime programore të transmetimit publik, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore ndaj operatorëve Global Sat, Infel-KTV, Kabel-Net, Pet Net, Altra Sat 2000, Inel Internacional, Kabel Kabel L Net, Robi; Transhpед Trejd dhe KDS-Kabel Net. Mbikëqyrja tregoi se operatori Altra Sat 2000 i cili sipas notifikimit të Agjencisë mund të kryejë veprimtarinë e tij në territorin e komunës Ohër, më 10 Mars për përdoruesit e tij i ka ritransmetuar shërbimet programore „RTR Planeta“, „Russia 24“, „Al Jazeera“ dhe „DM Sat“, të cilat nuk janë të përfshira në çertifikatën e regjistrimit të shërbimit programor nga Agjencioni.

### Masat e shqiptuara vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë në seancën e 11-të e mbajtur më 18 mars 2022, në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja e kryer u përcaktua mosrespektim i detyrimit për regjistrim të shërbimit programor që operatori Altra-Sat 2000 nga Ohri i ritransmetoi për përdoruesit e tij, miratoi vendim për vërejtje publike dhe për përgjashtimin e ritransmetimit të TV kanaleve të diskutueshme. Në këtë seancë u miratua vendim për marrjen e masës vërejtje publike për TV Due nga Gostivari, sepse nuk ka publikuar të dhëna që televizioni është i detyruar të transmetojë në vendin e përshtatshëm për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të e mbajtur më 10 mars 2022 miratoi katër vendime për shqiptimin e masës vërejtje publike për TV DUE nga Gostivari, TV Gurra nga Kërçova dhe G-TV Televizion nga Gostivari. Ndaj G-TV Televizion, TV Due dhe TV Gurra u shqiptuan masa vërejtje publike për shkak se në shërbimet e tyre programore nuk kanë transmetuar minimum 30% program burimor i krijuar si vepra audio dhe audiovizuale maqedonase në periudhë nga ora 7:00 deri më 19:00. Gjithashtu ndaj TV Due masë vërejtje publike i'u shqiptua dhe për mosrespektim të detyrimit për përdorimin e gjuhës në programe.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 8-të e mbajtur më 3 mars 2022 bazuar në konstatimet nga mbikëqyrja e kontrollit administrativë miratoi vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për TV Gurra nga Kërçova për shkak të mosdhënies së informacionit të cilin duhet ta bëjë të disponueshme për përdoruesin.

